



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 371/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhammed Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bashkim Ademaj Zyrtar i Lartë komunal Zgjedhor (ZLKZ) dega në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Demë Çeta – LDK-së dega në Istog, për shkak të mbajtjes së tubimit publik, në seancën e panelit të mbajtur me 01.11.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Bashkim Ademaj (ZLKZ)- dega në Istog kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) i shqiptohet dënimini më gjobë në vlerë prej 500(pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 29.10.2013, nga Bashkim Ademaj (ZLKZ) dega në Istog, në të cilën theksohet se me datën 22 tetor 2013, kanë marrë një shkresën zyrtare nga Rreshteri Policor – Sylë Mehmetukaj nga stacionit policor në Istog. Sipas kësaj shkrese me datën 09.10.2013 rrëth orës 19:00 në shkollën fillore “Ismail Qemali” në fshatin Saradran derisa LVV kanë mbajtur tubim politik të lajmëruar dhe të aprovuar , kurse kryesia e nëndegës së LDK-së në fshatin Saradram kanë mbajtur një mbledhje të kryesisë të palajmëruar dhe të pa aprovuar. Në këtë mbledhje të LDK-së kanë marrë pjesë 20 përrsona në krye me Demë Qetaj të cilët rrëth orës 19:20 kanë ndërpërre mbledhjen dhe janë larguar qetë.

PZAP-i, e informoi subjektin politik LDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 30.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik LDK dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 31.10.2013 sipas afatit të caktuar. PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik LDK, në të cilën deklaron se ankesa në fjalë është e pabazë duke theksuar se ne kemi mbajtur një mbledhje të punës së kryesisë së nëndegës dhe jo tubim parazgjedhor, dhe kërkon nga PZAP që ta hudh ankesën poshtë si të pabazë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

## Ankesa është e bazuar

Neni 4.2 i Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, lidhur me Fushatën Zgjedhore dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike, në mënyrë decidive thekson se të gjitha subjektet e certifikuara politike që dëshirojnë të organizojnë dhe të mbajnë një tubim politik gjatë periudhës së fushatës zgjedhore duhet që për raste të tilla te Zyrtari i Lartë Komunal i Zgjedhjeve i asaj Komune (ZLKZ), të dorëzojnë formularin e plotësuar të njoftimit për mbajtjen e atij tubimi politik me së voni shtatëdhjetë e dy (72) orë përpëra mbajtjes së saj. Prandaj me këtë rast subjekti politik LDK nuk e ka njoftuar organin kompetent komunal, në këtë rast ZLKZ, për mbajtjen e këtij tubimi, andaj mbi këtë bazë dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 dhe 120.1 pika c) të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendim

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashresa

Anr. 371/2013 më datën 01.11.2013



#### **Këshillë Juridik:**

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore